

Njoftim për Media

Tiranë, 30 Qershor 2024: Pyetëtori i Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023 është ndërtuar në ndjekje dhe zbatim të rekomandimeve ndërkombëtare si rekomandimet e Kombeve të Bashkuara të Komisionit Ekonomik për Evropën për raundin e censeve 2020 dhe rregulloren e Bashkimit Evropian, si dhe rekomandimeve të Eurostat-it.

[Pyetëtori i Censit të Popullsisë dhe Banesave](#) (link)

Pyetëtori i “Censit të Popullsisë dhe Banesave” është i ndarë në dy shtylla kryesore:

- Pyetje të detyrueshme, të cilat kanë një interes të përbashkët dhe janë të nevojshme për krahasime statistikore në nivel ndërkombëtar;
- Pyetje jo të detyrueshme, të cilat janë opsionale dhe janë të nevojshme në varësi të situatës dhe kërkesave specifike të vendit.

INSTAT ka organizuar një sërë takimesh konsultative mbi Pyetëtorin e Censit të Popullsisë dhe Banesave, ku janë diskutuar me aktorë të interesuar, çështje për t’u përfshirë në pyetësor. Aktorët e ndryshëm kanë shprehur interesat e tyre specifike në lidhje me temat si përkatësia etnike, besimi fetar, gjuha, aftësia e kufizuar, migracioni, etj. duke dakortësuar përbërjen dhe kategoritë e pyetjeve të Cens.

[Aktivitetet Censit të Popullsisë dhe Banesave](#) (link)

[Takim Konsultativ me përfaqësuesit e Bashkësive Fetare](#) (link)

[Tryezë Konsultative me minoritetet dhe grupet etno-kulturore](#) (link)

Gjatë konsultimeve me grupet etnike apo pakicat kombëtare është dakortësuar emërtimi i kategorive të paracaktuara në pyetësorin e Cens, kjo gjithashtu mbështetur edhe në bazën ligjore përkatëse, Ligjin mbi mbrojtjen e pakicave kombëtare në Republikën e Shqipërisë.

Nënvizojmë se në pyetësorin e Cens dhe mbledhjes së të dhënave në terren, kategoria ka qenë emërtimi i saktë i grupit etnik "maqedonase" duke hequr çdo dyshim për mungesë korrektesie apo përdorim të një emërtese të gabuar.

Pyetja mbi përkatësinë etno-kulturore bazohet në vetëdeklarimin e lirë të individit, duke bërë të mundur edhe përfshirjen e kategorisë “Preferoj mos të përgjigjem”. Pyetësi i Cens lejon gjithashtu mundësinë e deklarimit të një “Grupi tjetër etno-kulturor”, pavarësisht nga kategoritë e paralistuara duke siguruar mundësinë për çdo individ të vetëdeklaronte të dhënat dhe më pas konfirmimin e përgjigjes së vetëdeklaruar.

Procedura e ndjekur ka qenë korrekte dhe konform çdo standarti për të lejuar përfshirjen e çdo kategorie apo grupi etno-kulturor. Censusi bazohet në vetëdeklarimin e lirë të qytetarëve dhe sigurohet prej INSTAT dhënia e mundësisë për secilin të vetëdeklaronte të dhënat duke mos lejuar përjashtimet.

Gjatë përpunimit të rezultateve dhe redaktimit të raportit në shqip, rezultoi të jetë bërë një lapsus me termin e përdorur, i cili tashmë është korrigjuar nga INSTAT.

Duke qenë se bëhet fjalë për një gabim teknik, INSTAT shpreh keqardhjen dhe mirëkuptimin në incidentin e shkaktuar në komunitetin maqedonas.

Me korrigjimin e bërë, është eliminuar çdo arësye për keqkuptime të tjera.